



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____

VENDI _____

KOMUNA _____


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 127202315807

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të qaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë qasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për të plotësuar testin në dispozicion ke **120 minuta**.
- Shkruaj mirë, në mënyrë që shkrimi të jetë i lexueshëm, duke pasur kujdes që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, të shkruara sipas rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore.
- Kur të zgjedhësh detyrat tek të cilat duhet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejueshme (p.sh. duhet të shkruash emri, e jo em., ose gjinore e jo gjin., ose të shkurtesa tjera të ngjashme)
- Plotëso testin me **laps kimik ngjyrë të kaltër** (gjatë punës mund të përdorësh laps të thjeshtë grafik dhe gomë).
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps të thjeshtë grafik, laps kimik ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Bëj kujdes, sepse detyrat dallojnë për nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet () , të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat ku ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevc	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrethët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse përfundon më herët testin se sa koha e paraparë, dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

TESTI GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

1. Lexo me vëmendje tekstin në vijim.

Ajri

Toka është e mbështjellë nga një shtresë ajri afër 500 km e trashë që quhet atmosferë. Ajo i ndalon rrezet e rrezikshme të Diellit që të djegin Tokën. Ne nuk mund ta shohim ajrin, por e ndiejmë atë si erën. Ai përbëhet prej shumë gazesh, si oksigjeni, të cilin e thithim gjatë frymëmarrjes dhe dyoksidit të karbonit, që e nxjerrim gjatë frymëmarrjes dhe që shfytëzohet prej bimëve.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Teksti më lart është:

- tekst informues
- tekst letrar
- tekst shkencor

2. Në vendin bosh me vizë shkruaj (së paku 5) bashkëtingëllore të pazëshme.

_____.

3. Lexo me vëmendje fjalinë e dhënë.

Kaprolli vazhdonte metë njajtin ritëm me ec edhe me e ruajt të njajtën largësi.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Fjalja më lart:

- respekton rregullat gramatikore
- nuk respekton rregullat gramatikore

4. Cila prej fjalëve të mëposhtme nuk është e ndarë mirë në rrokje?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- shk-ro-nja-t zhur-më dë-gjo-i
- fja-lë ka-lë bu-ku-ri

5. Lexo fjalinë e dhënë dhe duke ngjyrosur rrethin poshtë fjalës përkatëse, trego ku bie theksi i fjalisë.

Ne po shkojmë në kinema.

-

6. Lexo fjalitë e më poshtme dhe trego se fjalët e nënvizuara në cilën formë të pashtjelluar të foljes janë përdorur.

Më pëlqen të fle duke dëgjuar muzikë.

Kohën më të madhe e kalonim duke parë vitrinat e dyqaneve.

Me siguri do ta gjesh duke fjetur.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- pjesore
- mohore
- paskajore
- përcjellore

7. Lexo vargjet e dhëna më poshtë dhe trego se për cilën dramë bëhet fjalë.

Por as të flas dhe as të hesht nuk mundem

Për fatin tim, i heq këto mundime

se vodha zjarrin fshehur në kallam

dhe njerëzve ua dhash si dhuratë

të çmuar q'u bë për ta mësues i arteve

i çdo mjeshtërie e mjet për të jetuar

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Edipi në Kolonë
- Ajaksi
- Antigona
- Prometheu i lidhur

8. Lexo tekstin me vëmendje dhe **ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.**

Novela është një lloj i prozës, më i shkurtër se romani, por më i gjatë se tregimi apo rrëfenja. Ajo ka një numër të kufizuar personazhesh; ngjarjet zhvillohen rrotull një motivi qendror dhe arrihet në një përfundim të befasishëm. Novela ka ngjashmëri me përrallën, veçanërisht ku tek ajo gërshetohen elementet reale me ato fantastike. Në novelë rrëfimi i autorit mbizotëron në raport me dialogun. Ashtu sikurse romani, edhe tregimi e novela janë të llojeve të ndryshme në varësi të temës që trajtojnë. Novela kanë shkruar: Kadare, Dikensi, Laço, Hemingueji etj.

Novela i përket:

- letërsisë popullore (gojore)
- letërsisë së shkruar artistike

9. Si quhen pjesët me të cilat ndërtohet drama? Plotëso vendin bosh me vizë për të dhënë përgjigje të saktë.

Drama ndërtohet me disa pjesë që quhen _____.

10. Lexo me vëmendje tekstin e dhënë më poshtë

Zjarr në Prizren

PRIZREN – Drejtoria e Policisë Rajonale në Prizren ka njoftuar se në qytetin e Prizrenit ka shpërthyer një zjarr. Sipas zyrtarëve të policisë, thuhet se shpërthimi i zjarrit ka shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme. Kjo ka ndodhur rreth orës 18:40 minuta në marketin "Cani", në rrugën "Enver Haradinaj. Në vendin e ngjarjes kanë arritur menjëherë zjarrfikësit dhe e kanë shuar zjarrin. Ai kishte djegur një pjesë të marketit dhe magazinën e tij. Vlera e dëmit mbetet e papërcaktuar. Hetuesit ende nuk kanë dalë në përfundime, por mendohet se shkak i shpërthimit të zjarrit ka qenë hedhja e pakujdesshme e bishtave të cigareve.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Teksti më lart i përgjigjet pyetjeve *ku?*, *kur?*, *kush?*, *pse?* dhe *si?*, të njohura në publicistikë si 'five w'. Përgjigjet në këto pyetje shërbejnë për të hartuar:

- referat
- reportazh
- intervistë
- lajm
- fejton

11. Lexo me vëmendje tekstin në vijim. Përqëndro vëmendjen te fjalët me të zeza.

*Gjyshi i Albit është fermer. **Ferma** e tij është **afër** qytetit. Në afërsi të fermës është një punishte për përpunimin e frutave. Aty punojnë shumë punëtorë. **Puna** e tyre është e lehtë.*

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Fjalët me të zeza janë fjalë:

- të parme
- jo të parme

12. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Mënyra e formimit të fjalëve *bregdet, hekurudhë, gojëmjaltë* është me:

- prejardhje
- përbërje
- përngjitje

13. Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Në fjalinë: *Më e madhe se trupit është dhembja e shpirtit*, rendi i kallëzuesit emëror është:

- në krye të fjalisë;
- në fund të fjalisë.

14. Çfarë kumtojnë fjalitë e mëposhtme? Ngjyros rrethin në shtyllën përkatëse për të lidhur fjalinë me atë që kumton.

	Gjendje	Porosi	Të dhëna	Përshkrim
Im atë ka qenë gjithnjë një baba i dhembshur.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Babai ishte i gjatë, me sy të kaltër e me lëkurë të pastër.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Motra sa s'fluturoi nga gëzimi kur mori vesh lajmin.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Mos nxito, se do të biesh.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

15. Cila nga veprat epike flet për luftën që grekët bënë kundër trojanëve, luftë që në poemë paraqiten 51 ditët e fundit dhe e cila nisi për shkak se Paridi, i biri i Priamit, rrëmbeu Elenën, gruan e grekut Menelaut?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Iliada Eneida Gilgameshi Odiseja

16. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe përqëndro vëmendjen te biesda mes malësorëve.

Gjahu i malësorëve

-Ç'muaj është tani?

-Janar.

-Sa ka muaji sot?

-Sot ka pesëmbëdhjetë ditë.

-Ka bërë mot të mirë.

-A dalim nesër për gjah?

-Dalim.-Me të vërtetë?

-Po, besa.

-Në ç'anë?

-Vemi në malt të Tomorit.

-Po atje të vemi e të gjuajmë, sepse atje ka mjaft egërsira. Atje ka edhe bisha, atje ka edhe derra të egër e ujq, çakej, arusha, drerë, kaproj, dhi të egra, dhelpira e lepuj. Atje ka edhe thllëza mali. Në marrshin erë qëntë e bien në ndonjë tufë të madhe, kemi për të vrarë shumë prej tyre. Nesër pra, të dalim për gjah.

- Fort mirë.

.....

Pjesë nga 'Gjahu i malësorëve' – Konstandin Kristoforidhi

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Shkrimi i pjesës më lart është gati tërësisht në:

- monolog dialog

17. Lexo tekstin e mëposhtëm.

LINDJA E HYJNESHËS ATHINA

Hyjnesha Athina - Pallada lindi nga vetë Zeus rrufehedhësi. Ky e dinte se hyjnesha e arsyes, Metida, do të lindte dy fëmijë: njëra vajzë, Athinaja, dhe tjetri djalë me fuqi e mendje të jashtëzakonshme. Moirat, perëndeshat e fatit, i shpalosën Zeusit të fshehtën se i biri i Metidës do ta rrëzonte nga froni dhe do t'ia rrëmbente pushtetin mbi gjithësinë. Zeusi i madh u frikësua. Për t'iu shmangur fatit të tmerrshëm, që i patën parathënë Moirat, ai e vuri në gjumë Metidën me fjalë të ëmbla, pastaj e gllabëroi përpara se ajo të lindte të bijën, hyjneshën Athina.

Nuk shkoi shumë dhe Zeusi filloi të ndiente një dhembje të madhe koke. Atëherë, ai thirri të birin, Hefestin dhe i dha urdhër t'ia hapte kokën që të shpëtonte nga dhembja e padurueshme dhe zhurmat në kokë. Hefesti ngriti sëpatën, qëlloi me forcë dhe ia hapi Zeusit kafkën në dysh pa e dëmtuar. Nga koka e rrufehedhësit doli në dritë një luftëtare e fuqishme, hyjnesha Athina-Pallada.

E armatosur më së miri me përkrenare flakëruese, heshtë dhe shqyt, ajo u shfaq përpara perëndive të habitura të Olimp. Hyjnesha vringëlloi me kërcënim heshtë vezulluese, ndërsa thirrja e saj luftarake gjëmoi anembanë qiellit duke dridhur deri në themele Olimp plot dritë. Ajo u paraqit përpara perëndive me tërë bukurinë dhe madhështinë e saj. Sytë e kaltër të Athinasë shkëndijonin nga urtësia hyjnore, ndërsa vetë ajo rrëzëllente nga një bukuri e fuqishme, e mrekullueshme, qiellore. Perënditë e pritën me brohori bijën e dashur të Zeusit, që kishte lindur nga koka e tij, mbrojtësen e qyteteve, perëndeshën e urtësisë dhe të dijes, luftëtaren e pamposhtur Athina-Pallada.

Athinaja është mbrojtësja e heronjve të Greqisë, u jep atyre këshilla plot urtësi dhe u vjen në ndihmë gjithmonë e pamposhtur, në rast rreziku. Ajo ruan qytetet, kështjellat dhe muret e tyre. Ajo fal urtësinë dhe dijen, u mëson njerëzve artet dhe zejjet. Edhe vajzat e Greqisë e nderojnë Athinanë, sepse ajo u mëson punën e dorës. Asnjëra, grua a hyjneshe qoftë, nuk ia kalon dot Athinasë në mjeshtërinë e endjes. Të gjithë e dinë sa e rrezikshme është të maten me të në këtë zeje, e dinë se si e pagoi Arakna, e bija e Idomit, që donte të dilte përmbi Athinanë në këtë mjeshtëri.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Athinaja lindi nga:

- Moirat, perëndeshat e fatit
- Koka e Zeusit
- Nimfa Jehonë
- Koka e Hefesit

18. Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, trego llojin e pasthirmave të shkruara me ngjyrë të zezë në tekstin më poshtë.

Oj, oj, ti qenke!

Oh, sa më gëzove!

Obobo, sa vonë qenka bërë! Eh! Sa kohë ka kaluar pa u parë me njëri-tjetrin!

Olele, më dhemb shumë gjuri!

Ptu, s'të vjen turp!

- Pasthirrma emocionuese
- Pasthirrma nxitëse
- Pasthirrma të përshëndetjes

19. Dallo funksionin e gjymtyrës së veçuar. Shkruaj me se shprehet ajo.

I *Fan Noli, një nga figurat e shquara të kulturës shqiptare, këshillon shkrimtarët e rinj.*

Me _____.

II *Qyteti i njëmbinjë dritareve, i ndërtuar 2400 vjet përpara, i befason vizitorët.*

Me _____.

20. Trego titullin e vjershës dhe autorin e saj.

*Erdhe në jetë
Nuk ka më nevojë për kuje lutje
Kryesorja të jetosh
Këtë gur ta hedhësh më larg se Unë
Prandaj:
Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: I pari
Ai që ka ekzistuar para teje jam Unë
Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama
për ëndrrat e mia e qetësinë je Ti
Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë
të natës
në pikë të vapës
Asgjë mos rrit asgjë mos krijë me dhunë
Rast i humbur nuk je edhe pse pylli
dendësohet
Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar
në botë
Dhe si të duash Ti Lumi
kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë
dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë
e saj e zezë
Bashkudhëtari im
Ta provojmë vetvetën derisa kemi frymë*

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Buzëdrinas – Agim Vinca
- Me jetue – Ali Podrimja
- Vdekja e gjyshes – Fatos Arapi
- Mbramja – Esad Mekuli

FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____

VENDI _____

KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR